

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR FINANCIMIN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË PAGESËS SË PUNONJËSVE DHE ISH-PUNONJËSVE TË KOMBINATIT MEKANIK POLIÇAN”**

#### **I. QËLLIMI I PROEJKTAKTT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj synon saktësimin e kërkesave dhe kritereve, si dhe të procedurave që do të ndiqen për financimin nga buxheti i shtetit dhe ekzekutimin e pagesës së trajtimit financiar, pagesën e detyrimeve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore të punonjësve dhe ish-punonjësve të Kombinatit Mekanik Poliçan, për vitet 2017-2023.

#### **II. VLERËSIMI I PROEJKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin analitik të Këshillit të Ministrave, por vjen si kërkesë e zbatimit të masave të marra për t'i ardhur në ndihmë punonjësve dhe ish-punonjësve të Kombinatit Mekanik Poliçan, në kuadër të përmirësimit të statusit të tyre ekonomik dhe social.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROEJKTALIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji saktëson kushtet dhe procedurën që do të ndiqet për të ndihmuar punonjësit dhe ish-punonjësit e Kombinatit Mekanik Poliçan, me qëllim përmirësimin e statusit ekonomik dhe social të tyre.

Projektligji synon trajtimin financiar, si dhe pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit dhe ish-punonjësit e Kombinatit Mekanik Poliçan, duke përballuar efektet financiare për 4 (katër) punonjësit aktualë, për vitet 2021- 2023 dhe për 127 punonjës të palikuiduar për periudhën shkurt 2017 deri më 31 dhjetor 2020.

Në vijim Ministria e Mbrojtjes do të ketë një qasje më të qartë për ndërmarrjet ushtarake, falë studimit të fizibilitetit që do të realizohet në bashkëpunim me NSPA (*NATO Support and Procurement Agency*).

Për sa më sipër, sqarojmë se gjobat dhe kamatëvonesat e krijuara në sistemin e DPT-së për Kombinatin Mekanik Poliçan do të merren parasysh për likuidim në vijim nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, në shpenzimet operative në programin buxhetor “Mbështetja e luftimit”, njësia shpenzuese “Komanda mbështetëse”.

Në lidhje me pagesat që do të kryhen për punonjësit aktualë dhe ish-punonjësit, sqarojmë se këto i referohen dokumentacionit i cili pas miratimit të këtij ligji do të dërgohet në degën e thesarit dhe do të përmbajë të dhënat, si më poshtë:

- a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS, ku janë të punësuar;
- b) të dhënat identifikuese të përfituesit, si:
  - i. emri e mbiemri i përfituesit;
  - ii. numri personal i identifikimit të përfituesit;
  - iii. numri i llogarisë rrjedhëse të përfituesit dhe emri i bankës përkatëse;
  - iv. urdhërpagesa 1900 (deklarata e gjeneruar nga sistemi efileting.tatime.gov.al).

Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, parashikohet se *“Shteti nuk financon humbjet e ndërmarrjeve shtetërore, përveçse me ligj, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo ka të bëjë me subvencionin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave”*.

Për sa më lart, është i domosdoshëm hartimi i këtij projektligji, si e vetmja mënyrë për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare të problematikës së krijuar me pagat dhe detyrimet mbi pagë sipas legjislacionit në fuqi, të krijuara ndër vite.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji është gjithashtu i harmonizuar me legjislacionin në fuqi për buxhetin e shtetit për vitin 2024 dhe legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet shtetërore.

Në këtë pikë sqarojmë se Kombinati Mekanik Poliçan gëzon statusin e një ndërmarrjeje shtetërore, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992,

“Për ndërmarrjet shtetërore”, ku shteti, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, është zotërues i vetëm i kapitalit të tij.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Projektligji nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROEJKTIGJIT**

Projektligji përbëhet nga 5 nene dhe synon të përcaktojë kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin financiar, si dhe pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit dhe ish-punonjësit e Kombinatit Mekanik Poliçan, si vijon:

Neni 1 përcakton që vlera e detyrimeve për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit aktualë dhe ish-punonjësit e ndërmarrjes “Kombinati Mekanik Poliçan” do të financohet me fonde buxhetore, pjesë e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Këto detyrime, sipas projektligjit, (neni 2) do të njihen nga Ministria e Mbrojtjes si detyrime të prapambetura.

Neni 3 i projektligjit përcakton se:

Efektet financiare të ligjit përballohen nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Mbrojtjes në zërin “Shpenzime korrente”. Ministria e Mbrojtjes miraton dhe përcjell për pagesë në degën e thesarit dokumentacionin justifikues, të përgatitur nga Kombinati Mekanik Poliçan, si më poshtë:

- a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS, ku janë të punësuar;
- b) të dhënat identifikuese të përfituesit, si:
  - i. emri e mbiemri i përfituesit;
  - ii. numri personal i identifikimit të përfituesit;
  - iii. numri i llogarisë rrjedhëse të përfituesit dhe emri i bankës përkatëse;
  - iv. urdhërpagesa 1 900 (deklarata e gjeneruar nga sistemi efileting.tatime.gov.al).

Neni 4 i projektligjit ngarkon Ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e tij dhe neni 5 përcakton hyrjen në fuqi, 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROEJKTAKTIT**

Me zbatimin e projektligjit ngarkohet ministri i Mbrojtjes.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROEJKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga ministri i Mbrojtjes.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare, sipas dokumentacionit të dërguar nga KMP-ja për detyrimet për paga dhe deklarimin e kontributeve në sistemin *e-filling*, janë në masën 58 500 000 (pesëdhjetë e tetë milionë e pesëqind mijë) lekë për pagat dhe 25 300 000 (njëzet e pesë milionë e treqind mijë) lekë për sigurime shoqërore, shëndetësore, në vlerën totale 83 800 000 (tetëdhjetë e tre milionë e tetëqind mijë) lekë, të cilat do të përballohen nga fondi i alokuar për Ministrinë e Mbrojtjes, në shpenzimet korrente në programin buxhetor “Mbështetja e luftimit”, njësia shpenzuese “Komanda mbështetëse”, brenda vitit 2024.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**

